Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0611

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP), si dhe nenit 21 dhe 29 te Rregullores së Punës së OSHP-së 01/2020 e amandamentuar më datën 09. 08. 2023, në përbërje nga Agon Ramadani - Kryetar, Vjosa Gradinaj-Mexhuani dhe Vedat Potërqoi - anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) "Internacional Group Base" SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-5718-2-1-1, me 20/10/2023, mori:

Vendim

1. **Aprovohet,** si e bazuar ankesa e OE "Internacional Group Base" SH.P.K. me nr. 2023/0611, e datës 24/08/2023, kurse vendimi i AK Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-5718-2-1-1 anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Internacional Group Base" SH.P.K.

Arsyetim

Faktet dhe rrethanat procedurale

Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 12.06.2023 ka publikuar Njoftimin për Kontratë lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Shërbimet e Pastrimit në Objektet e PK-së" me numër të prokurimit 214-23-5718-2-1-1.

AK me 15. 08. 2023 ka publikuar Njoftimin B58 ku ka rekomanduar për kontratë OE "Mobile Sanitary Services SHPK".

Me datë 21.08.2023 operatori ekonomik "Internacional Group Base" SH.P.K. ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimit të AK i cituar si më sipër, për të cilën AK vetëm ka

lëshuar një njoftim.

Me datë 24.08.2023 OE "Internacional Group Base" SH.P.K ka parashtruar ankesë në OSHP (evidentuar me numrin 611/23).

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak

OSHP ka konstatuar se ankesat i përmbajnë të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si të tilla janë parashtruar brenda afatit ligjor sipas nenin 109 paragrafin 1 të LPP, pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatorët ekonomik që janë palë të interesuara sipas nenit 4 paragrafit 1 nënparagrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këto ankesa sipas nenit 105 të LPP.

Paneli Shqyrtues ka konstatuar po ashtu se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nënparagrafin 75 të LPP. Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 29.08.2023 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore.

Lidhur me ankesën nr. 611/23, me datë 14.09.2023 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar;
- Të kthehet lënda në rivlerësim

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar me rregull të gjitha palët procedurale. Autoriteti Kontraktues ka deklaruar se pajtohet me rekomandimet e ekspertit shqyrtues ndërsa operatori ekonomik ankues ndërsa OE ankues nuk është deklaruar. Paneli Shqyrtues konstatoj se nuk ekzistojnë rrethana të konfliktit të interesit në kuptim të nenit 11 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit lidhur me nenin 4 paragrafin 1 nën paragrafin 75 të LPP.

Administrimi dhe vlerësimi i provave

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Internacional Group Base" SH.P.K janë parashtruar si në vijim:

- *Pretendimi i parë (I)*: "Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës nr.611/23 ka të bëjë me "Njoftimin" e AK-PK, përmes së cilit AK e ka hedhur sit ë paplotë kërkesën për rishqyrtim të OE ankues". "…ne nuk kemi mundësi te ndërhymë ne sistem dhe pse nuk kanë dalur te dhëna e tona ne kërkesë për ri-shqyrtim mund te jete vete mosfunksionim i sistemit por përderisa sa kanë shkuar nga useri (përdoruesi) jonë atëherë për AK janë të njoftuar ko të dhëna".

Konstatimet e ekspertit shqyrtues

Lidhur me pretendimet e OE, eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2023/0611 ka vlerësuar si në vijim:

- *Konstatimi i parë (I)*- AK-PK fillimisht pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim 21.08.2023, pasi kanë vërejtur se në kërkesën në fjalë-në vet dokumentin/kërkesën për rishqyrtim në faqe të parë mungojnë të dhënat e OE, siç janë emri, adresa postare etj…, përmes E-Prokurimi në rubrikën "Dokumentet-Letrat Standarde" ka ngarkuar një njoftim duke cituar dispozitat e nenit 60.3 të rregullores 001/2022 për prokurim publik, e cila dispozitë përcakton të dhënat që duhet të përmbaj ankesa. Provë: E-Prokurimi-Letrat standarde "Njoftim 21.08.2023". Me 23.08.2023 AK-PK e hedh kërkesën në fjalë si jo të plotë duke u thirrur në nenin 61.2 të rregullores "…Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësoj kërkesën e tij brenda një periudhe jo më të gjatë se dy (2) ditë nga marrja e kërkesës. Nëse parashtruesi i kërkesës nuk vepron sipas kërkesës së lartpërmendur, kërkesa për rishqyrtim do të refuzohen si e paplotë. OE ankues pretendon se i njëjti e ka të pamundur të ndërhyjë në të dhënat që shfaqen: "Njoftimin" e AK-PK, përmes së cilit AK e ka hedhur sit ë paplotë kërkesën për rishqyrtim të OE ankues". "…ne nuk kemi mundësi te ndërhymë ne sistem dhe pse nuk kanë dalur te dhëna e tona ne kërkesë për rishqyrtim mund te jete vete mosfunksionim i sistemit por përderisa sa kanë shkuar nga useri (përdoruesi) jonë atëherë për AK janë të njoftuar ko të dhëna". Me qenë se nga pozicioni i ekspertit shqyrtues të OSHP-së nuk jemi të njoftuar me detajet se si funksionon sistemi e-prokurimit nga pozicioni I Operatorit ekonomik, ne kemi kërkuar sqarime nga KRPP. Provë: Kërkesa jonë për sqarime drejtuar KRPP-së dhe përgjigjet e KRPP-së. Në përmbledhje kemi kërkuar sqarime se a është bërë kërkesa e AK-së për plotësim në formën e duhur dhe a ka mundësi OE të ndërhyjë në të dhënat që shfaqen ne kërkesë/faqe të parë. Nga KRPP me datë 13.09.2023 kemi pranuar përgjigje se: "Autoriteti kontraktues ne kuadër te detajeve te procedurës - folderit "Dokumentet-Letrat Standarde" ka opsionin qe përveç letrave standarde te dërgoj edhe çfarëdo dokumenti tek OE, përfshirë edhe dokument/kërkesë qe ka te beje me "kërkesë për rishqyrtim". Gjate përgatitjes se "kërkesës për rishqyrtim" nga ana e OE, ne hapat përkatës apo ne hapin e 3-te " Identifikimi i OE", sistemi automatikisht plotëson të dhënat e OE. Kjo pjese është e sqaruar edhe ne manualin për OE rreth përgatitjes dhe dorëzimit te kërkesës për rishqyrtim. Nëse te dhënat e hapave te përgatitjes se kërkesës për rishqyrtim nuk janë shfaqur ne dokumentin e kërkesës për rishqyrtim te krijuar ne hapin e 9-te, atëherë kjo është pasoje e sistemit gjate krijimit te dokumentit ne hapin përkatës ". Po ashtu në fund të përgjigjes së KRPP thuhet se: "Sidoqoftë, ne lidhje me këtë pjese apo ne momentin e krijimit te kërkesës për rishqyrtim, Manuali për OE rreth përgatitjes dhe dorëzimit te kërkesës për rishqyrtim, këshillon OE si ne vijim: "Kërkesa për rishqyrtim" duhet të shkarkohet me qëllim për të kontrolluar të dhënat e shënuar në hapat paraprak (nëse kërkesa e krijuar përmban të gjitha të dhënat në formë të saktë), dhe nuk kërkohet që kërkesa të nënshkruhet dhe vuloset nga ana e OE. Pra, vetëm kontrollohen të dhënat dhe nëse të gjitha të dhënat janë të sakta, atëherë vazhdon nëpërmjet butonit "Ruaj dhe vazhdo". Nëse, OE dëshiron t'a ngarkoj "Kërkesën për rishqyrtim" të nënshkruar dhe çfarëdo dokumente të tjera mbështetëse të "Kërkesës për rishqyrtim" atëherë këtë mund ta bëj duke përdorur butonat "Ngarko". Pas analizimit të pretendimeve ankimore, njoftimeve të AK-së dhe ne veçanti sqarimeve të ofruara nga KRPP, japim vlerësimet tona si në vijim: 1. Mungesa e të dhënave të OE (emri, adresa postare, adresa elektronike, numri tel) në brendi të dokumentit/kërkesës faqe të parë, nuk ka ndodhur me fajin e OE ankues, këto të dhëna sipas sqarimeve të KRPP plotësohet automatikisht nga sistemi. Sipas sqarimit të KRPP, autoriteti kontraktues "ka opsionin qe përveç letrave standarde te dërgoj edhe çfarëdo dokumenti tek OE, përfshirë edhe dokument/kërkesë qe ka te beje me "kërkesë për rishqyrtim". Në rastin konkret AK-PK nuk ka dërguar tek OE "Kërkesë" për plotësim, dhe ka ngarkuar "Njoftim" në rubrikën "Dokumentet Letrat Standarde". Neni 61.2 i rregullores ndër tjera thotë

"...Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësoj kërkesën e tij.." Në "Njoftimin" e AK-PK askund nuk "kërkohet" nga aplikuesi të "plotësoj" kërkesën e tij. Provë: E Prokurimi - Letrat Standarde Njoftimi 21.08.2023. Në rastin konkret, mendimi ekspertit është se AK është dashtë që mënyrë të qartë dhe koncize të dërgoj "kërkesë" për plotësim të kërkesës për rishqyrtim. AK në këtë rast nuk ka dërguar "Kërkesë", e as nuk ka kërkuar "plotësim të kërkesës", siç parashihet me dispozitat e nenit 60.1 të rregullores 001/2022. Në përgjigje/sqarime të KRPP-së po ashtu thuhet se në manualin për OE, të njëjtit "këshillohen" të shkarkojnë kërkesën për ta kontrolluar se mban gjitha të dhënat, megjithatë as nga sqarimet e KRPP e as nga njoftimet e AK-PK nuk ka ndonjë udhëzim se si mund të korrigjohen të dhënat e OE nëse ato janë të pasakta, pasi siç e kemi kuptuar gjatë shqyrtimit të kësaj ankese dhe përgjigjeve të KRPP, operatorët ekonomik nuk mund të ndërhyjnë në këto të dhëna dhe "sistemi automatikisht plotëson të dhënat e OE". Bazuar në gjitha këto që u cekëm më lart, mendimi i ekspertit është se nuk janë plotësuar kushtet e nenit 61.2 lidhur me nenin 60.3 të rregullores 001/2022, dhe OE ankues i është pamundësuar realizimi i të drejtës për Zgjidhje Preliminare e mosmarrëveshjeve sipas neni 108/A. Mbi këtë bazë eksperti shqyrtues vlerëson se nuk kemi nevojë të lëshohemi në pretendimet tjera të OE ankues, dhe rekomandojmë që lënda të kthehet në Rishqyrtim pranë AK-PK, me qëllim që AK-PK në pajtim me nenin 108/A të LPP-së të përgjigjet në gjitha pretendimet e OE ankues dhe të nxjerr "Vendim" mbi kërkesë për rishqyrtim në përputhje me dispozitat e LPP-së.

-Konstatimet dhe përfundimet e Panelit Shqyrtues

Paneli konsideron se eksperti shqyrtues ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të gjitha pretendimet e operatorit ekonomik ankues "Internacional Group Base" SH.P.K.. Argumentimet në raportin e cituar si më sipër të ekspertit shqyrtues janë të detajuara, të kuptueshme dhe të bazuar në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Për më tepër konstatimet e ekspertit shqyrtues janë të bazuara edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP dhe rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me analizimin e pretendimeve të ankuesve i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues. Në ketë rast Paneli konsideron se: Pretendimet ankimore të ankuesit "Internacional Group Base" SH.P.K, janë të qëndrueshme.

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtresat dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur e tij/sajë, se AK nuk vepruar konform dispozitave të cituara si raportin e ekspertizës, Në ketë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel. Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi,

e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, ka arritur në vendimin përfundimtar se lënda duhet të kthehet në rivlerësim dhe të trajtohen pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesi konform nenit 108/a, ndërsa si rrethana kyçe që orientuan drejt vendim-marrjes sikurse në dispozitiv, pa nevojën e ripërsëritjes së elobarimeve të ekspertit në të cilat paneli ka gjetur mbështetje, kanë qenë faktet e paraqitura që përveç që OE ankues është indentifikuar në platformën eprokurimi, poashtu përmes KRPP-së është sqaruar se faqja mbi indentifikimin e OE-ve plotësohet automatikisht nga sistemi. Sipas sqarimit të KRPP, autoriteti kontraktues "ka opsionin qe përveç letrave standarde te dërgoj edhe çfarëdo dokumenti tek OE, përfshirë edhe dokument/kërkesë qe ka te beje me "kërkesë për rishqyrtim". Në rastin konkret AK-PK sipas të dhënave nuk dërguar tek OE "Kërkesë" për plotësim, dhe ka ngarkuar "Njoftim" në rubrikën "Dokumentet Letrat Standarde". Neni 61.2 i rregullores ndër tjera thotë "...Autoriteti Kontraktues, respektivisht Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit, do të kërkojë nga aplikuesi që të plotësoj kërkesën e tij.." Në "Njoftimin" e AK-PK askund nuk "kërkohet" nga aplikuesi të "plotësoj" kërkesën e tij, ndërsa në rastin konkret pesha e përgjegjësisë sipas panelit nuk mund të i ngarkohet OE-së ankuese në plotni për faktin që sipas sqarimeve të njejtit poashtu nuk mund të ndërhyjnë në plotësimit e asaj faqe e poashtu nuk ka një shpjegim se si do të mund të përmirësohej situata.

Prandaj duke ju referuar të lartcekurave dhe duke u bazuar në administrimin e gjithmbarshëm të provave, në dispozicion të shkresave të kësaj lënde, Paneli Shqyrtues bazuar në nenin 98, 99 lidhur me nenin 104 dhe 118 të LPP, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- AK - **POLICIA E KOSOVËS**
- OE - **INTERNACIONAL GROUP BASE SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: